


Tregtia e jashtme e mallrave

Korrik 2025

Tiranë, më 18 Gusht 2025: Në Korrik 2025 eksportet e mallrave arritën vlerën 35 mld lekë, duke u rritur me 5,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 0,5 %, në krahasim me Qershor 2025. Importet e mallrave arritën vlerën 83 mld lekë, duke u ulur me 2,4 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 9,1 %, në krahasim me Qershor 2025. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 48 mld lekë, duke u ulur me 7,5 %, krahasuar me Korrik 2024 dhe duke u rritur 17,3 %, në krahasim me Qershor 2025.


Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Në këtë shtatëmuor eksportet e mallrave arritën vlerën 239 mld lekë, duke u rritur me 2,6 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 515 mld lekë, duke u ulur me 2,1 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 276 mld lekë, duke u ulur me 5,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:


Gjatë muajit Korrik 2025, në rritjen e eksporteve prej 5,7 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +12,8 pikë përqindje, “Makinëri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,2 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +0,8 pikë përqindje, etj. Negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -8,0 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me -1,3 pikë përqindje.

Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Korrik 2025

Eksportet, gjatë këtij shtatëmuajori janë rritur me 2,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +9,2 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,1 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,3 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,7 pikë përqindje, etj.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Korrik 2025, në uljen e importeve prej 2,4 %, krahasuar me një vit më parë, kanë ndikuar negativisht grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,0 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -1,7 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: Ushqime, pije, duhan” me +0,9 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,7 pikë përqindje.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Korrik 2025

Si shtatëmujor, importet janë ulur me 2,1 %, krahasuar me shtatëmujorin e parë 2024. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -1,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,2 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, piqe, duhan” dhe “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +0,5 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,3 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Korrik 2025, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Korrik 2024 janë: Kosova (72,5 %), Greqia (14,8 %), Gjermania (0,6 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (6,4 %), Maqedonia e Veriut (32,7 %) dhe Turqia (3,2 %).

Gjatë këtij shtatëmujori vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (72,5 %), Greqia (9,6 %) dhe Gjermania (8,9 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (10 %) dhe Maqedonia e Veriut (30,1 %).

Në muajin Korrik 2025, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Italia (10,3 %), Gjermania (16,6 %) dhe Kosova (21,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kina (7,6 %), Turqia (12,0 %) dhe Greqia (5,0 %).

Gjatë këtij shtatëmujori, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (3,7 %), Turqia (14,6 %) dhe Gjermania (6,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritje më të madhe janë: Kina (21,8 %), Greqia (2,8 %) dhe Spanja (14,9 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Korrik 2025



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 55,1 % të gjithë tregtisë. Në Korrik 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 67,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 49,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (25,7 %), Kina (10,1 %), Greqia (7,8 %) dhe Turqia (7,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për shtatëmuajorin e parë 2025, me vendet e BE-së zënë 56,7 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar-Korrik 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 67,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (26,9 %), Kina (9,3 %), Greqia (7,6 %) dhe Turqia (7,1 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Korrik 2025

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024		373	-15,4	894	2,5	-522	41,7
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	09 - 23	34	-12,8	73	-16,6	-40	45,8
	10 - 23	37	-4,3	78	-6,3	-42	46,8
	11 - 23	33	-21,8	72	-7,4	-39	46,0
	12 - 23	38	-6,6	73	-23,1	-35	51,7
	Jan-Dhj 23	440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	04 - 24	35	1,8	75	0,6	-41	45,9
	05 - 24	35	-12,4	79	-1,6	-45	43,8
	06 - 24	35	-8,9	77	2,1	-42	45,3
	07 - 24	33	-12,0	85	21,1	-52	39,0
	08 - 24	22	-18,2	69	1,9	-46	32,6
	09 - 24	31	-8,5	71	-3,1	-40	43,3
	10 - 24	31	-15,2	77	-1,5	-46	40,3
	11 - 24	30	-8,5	73	2,0	-43	41,2
	12 - 24	26	-31,7	79	8,3	-53	32,6
	Jan-Dhj 24	373	-15,4	894	2,5	-522	41,7
2025	01 - 25	31	4,9	60	0,1	-29	51,8
	02 - 25	34	4,3	68	-8,6	-34	49,7
	03 - 25	35	4,9	74	-1,4	-39	47,3
	04 - 25	33	-4,1	76	0,4	-43	43,8
	05 - 25	35	1,2	78	-2,1	-42	45,3
	06 - 25	35	1,9	77	-0,2	-41	46,2
	07 - 25	35	5,7	83	-2,4	-48	42,2
	Jan-Korr 25	239	2,6	515	-2,1	-276	46,3

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Korrik 2025

	Eksporte				Importe			
	Korrik 2024	Korrik 2025	Jan. - Korr. 2024	Jan. - Korr. 2025	Korrik 2024	Korrik 2025	Jan. - Korr. 2024	Jan. - Korr. 2025
Vendet e BE-së	23.928	23.744	166.289	160.453	43.709	41.677	272.886	266.696
Austri	149	97	1.551	980	857	553	4.577	4.149
Gjermani	1.938	1.951	13.052	14.212	6.312	5.263	37.614	35.086
Greqi	2.392	2.748	14.551	15.948	6.234	6.543	40.492	41.626
Itali	14.894	13.946	102.912	92.572	18.441	16.545	114.209	109.955
Spanjë	1.065	1.517	7.648	10.161	1.117	1.629	8.009	9.203
Kroaci	296	365	2.756	1.813	766	830	2.723	4.299
Të tjera të BE-së	3.194	3.122	23.819	24.768	9.982	10.314	65.261	62.378
Mbretëri e Bashkuar	155	119	938	703	1.146	811	5.975	5.344
Kinë	792	1.060	6.163	5.672	10.121	10.895	52.549	64.023
Kosovë	3.738	6.449	23.801	41.054	2.069	1.624	8.914	7.491
Maqedonia e Veriut	1.001	674	8.388	5.863	1.121	1.423	7.099	7.828
Rusi	-	-	5	6	530	261	2.172	1.993
SHBA	652	267	2.766	2.461	1.388	2.158	11.623	10.853
Turqi	347	335	2.478	2.784	7.151	8.012	59.577	50.869
Ukrainë	50	24	2.453	365	645	209	2.696	2.138
Zvicër	263	133	1.562	830	894	1.204	4.551	5.520
Të tjera	2.393	2.406	17.745	18.384	16.695	15.166	97.663	92.081
Gjithsej	33.320	35.211	232.589	238.576	85.471	83.441	525.705	514.835

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Qershor 2025

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Korrik 2024	Korrik 2025	Jan. - Korr. 2024	Jan. - Korr. 2025	Korrik 2024	Korrik 2025	Jan. - Korr. 2024	Jan. - Korr. 2025
Gjithsej	33.320	35.211	232.589	238.576	85.471	83.441	525.705	514.835
Ushqime, pije, duhan	4.519	4.786	32.080	34.696	15.345	16.141	90.171	93.053
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	5.416	9.679	44.239	65.544	9.186	9.764	51.189	53.667
Produkte kimike dhe plastike	1.826	1.388	9.479	7.793	10.274	10.846	68.404	69.831
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	169	150	1.325	1.160	975	933	7.318	6.850
Prodime druri dhe letre	949	869	5.971	6.023	3.079	2.855	17.821	17.352
Tekstile dhe këpucë	9.931	10.051	65.347	64.767	7.974	7.520	50.668	50.043
Materiale ndërtimi dhe metale	6.430	3.767	43.273	28.512	11.928	10.233	75.259	69.129
Makineri, pajisje dhe pj. këmb.	3.131	3.525	22.342	23.473	22.750	21.335	141.337	131.974
Të tjera	949	995	8.532	6.608	3.960	3.816	23.538	22.934

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Korrik 2025

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	102.912	92.572	23.801	41.054	14.551	15.948	13.052	14.212
Ushqim, pije duhan	8.447	7.337	3.867	4.342	2.562	2.839	1.072	1.041
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	8.283	4.170	5.060	30.064	2.134	2.373	3.834	3.468
Produkte kimike dhe plastike	3.578	2.730	2.457	1.826	587	503	27	40
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.117	975	4	12	145	108	1	-
Prodhime druri dhe letre	3.231	3.191	691	643	956	951	68	77
Tekstile dhe këpucë	49.435	47.126	100	63	4.894	5.784	5.627	6.486
Materiale ndërtimi dhe metale	13.547	12.455	9.534	1.811	2.629	2.588	519	551
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	12.015	11.273	1.296	1.634	141	162	1.640	2.239
Të tjera	3.258	3.314	792	659	504	642	263	309

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Korrik 2025

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	114.209	109.955	52.549	64.023	59.577	50.869	40.492	41.626
Ushqim, pije duhan	18.227	20.072	1.017	1.180	3.223	3.123	11.197	12.243
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3.251	3.354	14	9	7.745	5.011	6.161	5.530
Produkte kimike dhe plastike	13.993	13.797	4.331	5.120	7.178	6.807	6.837	7.438
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	5.700	5.312	572	553	207	246	118	83
Prodhime druri dhe letre	3.672	3.844	1.104	1.247	2.870	2.651	2.456	2.489
Tekstile dhe këpucë	22.018	21.271	7.834	8.121	6.732	5.647	3.956	4.415
Materiale ndërtimi dhe metale	13.716	12.778	7.192	10.540	16.956	17.375	5.581	4.869
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	26.886	23.712	25.889	31.852	12.103	7.409	2.689	3.230
Të tjera	6.745	5.815	4.595	5.401	2.563	2.600	1.498	1.329

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri